

## **Praktikë në Kontabilitet/Financa me mundësi punësimi**

Kompania e kontabilitetit dhe financave **SAF Kosova L.L.C** ofron shërbime këshilluese dhe mbështetëse për kontabilitet, tatime dhe konsulencë financiare për një gamë të gjerë të bizneseve, individëve dhe organizatave joqeveritare. **SAF Kosova L.L.C.** posedon njohuri të larta për tregun si dhe kushtet ekonomike të Republikës së Kosovës së bashku me një profesionalizëm dhe etikë të lartë të punës, duke iu ofruar kështu klientëve zgjidhje për të gjitha shërbimet financiare që iu nevojiten. Qëllimi ynë është ti ofrojmë klientëve tanë një shërbim profesional dhe të vazhdueshëm duke lidhur kështu një marrëdhënie afatgjatë si këshilltari juaj i besueshëm financiar.

**SAF Kosova po kërkon njerëz të talentuar për punë praktike me mundësi punësimi:**

### **Kualifikimet e kërkuara:**

- Të ketë të përfunduar studimet bachelor (ose absolvent) në Fakultetin Ekonomik, (përparësi kanë studentët e drejtimit të kontabilitetit dhe SCAAK),
- Aftësi të mira komunikimi ndërpersonale,
- Interes i fortë në kontabilitet dhe financa,
- Zotërim i mirë i gjuhës angleze,
- Njohuri të mira të aplikacioneve të MS Office (Excel, Word, etj),
- Fleksibilitet dhe aftësi për të punuar nën presion,
- Aftësia për të punuar individualisht dhe/ose në ekipe.

### **Përfitimet dhe çfarë ne ofrojmë:**

Gjatë praktikës suaj në SAF Kosova, do të keni mundësi të thelloni aftësitë dhe njohuritë tuaja në kontabilitet dhe raportimit financiar, Mundësi për të mësuar, Një mjedis profesional pune ku inkurajohen zhvillimi dhe rritja personale, Mundësi trajnimi dhe zhvillimi të karrierës.

### **Procedura e aplikimit:**

Të interesuarit për të marrë këtë pozitë dërgoni CV-në tuaj në E-mail: [info@saf-ks.com](mailto:info@saf-ks.com)  
Afati për aplikim është deri më datë 30 Qershor 2021.

*Kandidatët e përzgjedhur për konsulta të mëtutjeshëm do të kontaktohen për test dhe intervistë.*